

VENDIM
Nr. 332, datë 2.6.2021

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT, PËR PAGESËN E STUDIOS PËR
ÇËSHTJEN E ANULIMIT TË VENDIMIT TË ARBITRAZHIT ICSID CASE NR.
ARB/14/26**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime korrente”, të programit buxhetor 01110 “Planifikim, menaxhim, administrim”, t’i shtohet fondi prej 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekësh, për kryerjen e pagesës për detyrimet që rrjedhin ndaj Studios “Gowling” WLG për procesin e anulimit të vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar, datë 20.3.2020, ICSID Case No. ARB/14/26, ndërmjet shoqërisë “Albaniabeg Ambient” sh.p.k. dhe të tjerë, kundër Republikës së Shqipërisë.

2. Efekti financiar, prej 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe